



Udhëzues për Procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje

Prishtinë, Shtator 2011

Udhëzues për Procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje

Ky publikim është përgaditur nga ATRC, dhe përkrahur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.
Qëndrimet e shprehura në këtë udhëzues jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

Përmbajtja

Përmbledhje e përgjithshme	2
----------------------------------	---

Hyrje	3
-------------	---

Shembuj të aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje.....	3
Sembulli i aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje në Elbasan	6
Ndarja e qytetit të Elbasanit në zona	6
Cikli i buxhetimit me Pjesëmarrje sipas modelit të Elbasanit.....	7
Komiteti i buxhetimit me pjesëmarrje sipas modelit të Elbasanit	8

Qëllimi i buxhetimit me pjesëmarrje	9
---	---

Elementet kryesore të buxhetimit me pjesëmarrje	9
Informimi.....	9
Pjesëmarrja.....	9
Miratimi përfundimtar i buxhetit dhe roli i Kuvendit të Komunës	10
Komunikimi i rezultateve	10
Mekanizmat ligjor dhe rregullator për institucionalizimin e buxhetimit me pjesëmarrje	10

Hapat konkret drejt buxhetimit me pjesëmarrje të suksesshme	11
---	----

1. Ndani territorin e administruar nga komuna në njësi gjeografike dhe demografike	11
2. Informimi dhe motivimi i qytetarëve për pjesëmarrje në proces	11
3. Identifikimi i çështjeve dhe prioritetëve në komunitet	11
4. Renditja çështjeve dhe problemeve të komuniteteve	11
5. Monitorimi i projekteve	12

Parakushtet për proces efikas të buxhetimit me pjesëmarrje	12
--	----

1. Zyrat komunale për informim	12
2. Themelimi i grupeve përfaqësuese në komunitet	12
3. Web faqja e komunave	13
4. Forumet Publike	14
5. Web Diskutimet.....	14
6. Takimet e drejtpërdrejta me qytetarë dhe grupe interesi	14
7. Forumet qytetare	15
8. Shkëmbimi i përvojave në mes komunave.....	15
9. Kartat aktive të qytetarëve.....	15
10. Angazhimi i qytetarëve në komisionet për shqyrtimin e ofertave/tenderit	15
11. Drejtoritë Komunale hartojnë një plan të takimeve me grupe interesi.....	16

Rekomandimet për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje	17
---	----

Rekomandimet për komunat.....	17
-------------------------------	----

Rekomandimet për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OShC)	18
--	----

Misioni i ATRC-së	19
-------------------------	----

Përmbledhje e përgjithshme

Qytetarët e Kosovës në dekadën e fundit janë përballur me lloje të ndryshme të administratave dhe si rrjedhojë edhe praktika të ndryshme të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Pas shpalljes së pavarësisë në Shkurt të vitit 2008, Kushtetuta e re e Republikës së Kosovës e ka hequr nivelin e mesëm të qeverisjes, të njohur si administrata regjionale që ishte vendosur nga misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK).

Tani, struktura qeverisëse e Kosovës përbëhet nga dy nivele, pra nivelet qendrore dhe lokale të organeve qeverisëse. Ky raport do të merret me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal, që është e njohur për qytetarët si Komuna. Kosova përbëhet nga 38 njësi komunale, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilave janë rregulluar me ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u garanton qytetarëve pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në vendimmarrje në nivelin lokal: pjesëmarrje në seancat e Kuvendit të Komunës në cilësinë e vëzhguesit, pjesëmarrje në takime publike, pjesëmarrje në dëgjime publike, të drejtën e peticionit, referendumit etj. Edhe pse ligji ka garantuar mënyra dhe metoda të ndryshme të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, sfidë e vazhdueshme mbetet motivimi i qytetarëve për të qenë pjesë e proceseve në nivel lokal. Shumica e qytetarëve nuk kanë informata të mjaftueshme dhe nuk janë të vetëdijshëm për këto mekanizma të një shoqërie demokratike. Për më tepër, qytetarët nuk janë të informuar se ata mund të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes në administratën e tyre komunale dhe të sigurohen që vendimet të merren në dobi të tyre.

Ligji obligon komunat që paralelisht me krjimin e parakushteve ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve, të organizojnë edhe fushata informimi dhe inkurajimi për ekzistimin e mekanizmave dhe mënyrat e shfrytëzimit të tyre.

Niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në 38 komunat e Kosovës është i ndryshëm dhe si rrjedhojë edhe përpjekjet dhe gatishmëritë e administratave komunale për ta rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe transferimin e kompetencave në lidhje me disa vendime të komuniteteve nuk është në të njëjtin nivel. Prandaj, një qasje e re, një praktikë e re e komunikimit Komunë – qytetar duhet të ndërtohet dhe si rrjedhojë përfshirje më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Hyrje

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një praktikë financiare që ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e çështjeve financiare. Ky është një mekanizëm që përfshin dhe i fuqizon njerëzit duke siguruar një shpërndarje më të barabartë të investimeve. Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje është aplikuar fillimisht në Amerikën Latine dhe në Evropë, kurse tani është përhapur edhe në vendet tjera. Është vlerësuar se aktualisht, numër i madh i shteteve janë duke e aplikuar metodologjinë e buxhetimit me pjesëmarrje. Nga aplikimi i buxhetimit me pjesëmarrje përfitojnë të gjithë qytetarët pa dallim, e në veçanti qytetarët e zonave rurale, të cilët për arsye të ndryshme nuk janë trajtuar dhe shërbyer mirë nga administrata komunale.

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një proces i diskutimit demokratik dhe vendimmarrjes dhe një lloj i demokracisë pjesëmarrëse, në të cilën njerëzit e zakonshëm vendosin se si ta ndajnë të gjithën ose një pjesë të buxhetit komunal. Buxhetimi me Pjesëmarrje i lejon qytetarët për të identifikuar dhe prioritetizuar projektet e shpenzimeve publike dhe u jep atyre fuqinë për të marrë vendime të drejta për mënyrën se si shpenzohen paratë.

SHEMBUJ TË APLIKIMIT TË BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE

1. Qyteti i Porto Alegre¹ ishte pionier i buxhetimit me pjesëmarrje, i cili qysh në vitin 1989 filloi aplikimin e këtij procesi. Buxhetimi me pjesëmarrje ishte planifikuar të jetë një praktikë gjithëpërfshirëse e menaxhimit, çka e solli popullsinë drejtpërdrejtë në formulimin dhe ekzekutimin e projekteve të buxhetit kapital të qytetit.

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje mbështetej shumë në përfshirjen e grupeve joformale në komunitet, OJQ-ve dhe sindikatave të punës dhe gjithashtu kërkonte që administrata e qytetit të vë në dispozicion burimet njerëzore dhe financiare për tu siguruar se ky proces do të funksionoj. Thelbi i praktikës përfshin krijimin e komisioneve apo forumeve qytetare të cilat ndihmojnë në formulimin e prioriteteve të buxhetit dhe pastaj vazhdojnë në mbikëqyrjen e punëve në proces e sipër. Që në fillim, procesi i aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje filloi ngadalë, meqë qyteti kishte relativisht pak para për projektet kapitale. Megjithatë, posa banorët filluan t'i vërejnë përfitimet e prekshme të pjesëmarrjes, gjithnjë e më shumë rritej edhe pjesëmarrja e qytetarëve në këtë proces. Në fillim të aplikimit të këtij procesi numëroheshin rreth 1500 qytetarë të cilët merrnin pjesë aktivisht, kurse pas një periudhe shumë të shkurtër kohore më shumë se 45.000 qytetarë, merrnin pjesë në këtë proces në baza vjetore. Për më tepër, koncepti i pjesëmarrjes tani është zgjeruar nga çështjet buxhetore në shumë aspekte të menaxhimit të pushtetit vendor, duke përfshirë planifikimin e

¹ Pioner në buxhetimin me pjesëmarrje – Porto Alegre, Brazil

politikave. Një çështje që u shfaq ishte nevoja për tu siguruar që edhe planifikimi rajonal dhe shqetësimet rajonale ishin përfshirë në procesin e planifikimit. Kjo u arrit nëpërmjet pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e kuvendeve plenare tematike, të cilat adresonin shqetësime të ndryshme të qytetarëve në nivel lokal dhe regional. Një çështje e dytë që menjëherë u ngrit kishte të bënte me marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, këshilltarëve dhe Parlamentit komunal dhe forumeve vendore. Në Porto Alegre, 100% e buxhetit konsiderohet si pjesëmarrës. Këshilli i Buxhetimit me pjesëmarrje, i përbërë nga delegatë të zgjedhur dhe qytetarë, shqyrton dhe ndikon në buxhetin e përgjithshëm para se ai të dërgohet në Këshillin e Qytetit.

2. Rasti i Barra Mansa² e ilustron zhvillimin e Këshillit të Buxhetimit me Pjesëmarrje të Fëmijëve në qytetin e Barra Mansa (Brazil), në të cilën 18 djem dhe 18 vajza janë zgjedhur nga kolegët e tyre për t'u siguruar se këshilli komunal i adreson nevojat dhe prioritetet e tyre. Ky këshill përcakton se si një pjesë e buxhetit komunal (rreth US \$ 125.000 në vit) është shpenzuar në adresimin e prioritetëve të fëmijëve. Më vonë këshilltarët fëmijë janë përfshirë edhe në aspekte të tjera të qeverisjes lokale. Çdo vit që nga viti 1998, më shumë se 6.000 fëmijë kanë marrë pjesë në diskutime dhe kuvendet e tyre për të zgjedhur këshilltarët-fëmijë dhe për t'i diskutuar prioritetet e tyre. Fëmijët e zgjedhur mësojnë se si t'i përfaqësojnë bashkëmoshatarët e tyre në kuadër të strukturave demokratike, për t'i përcaktuar përparësitë në bazë të burimeve të disponueshme dhe pastaj për të zhvilluar projekte në kuadër të procesit kompleks dhe shpesh të ngadaltë politik dhe burokratik të qeverisjes së qytetit. Ky proces ka zgjeruar tek fëmijët konceptin e buxhetimit me pjesëmarrje që tashmë është përdorur gjerësisht në Brazil për përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen lokale.

3. Këshilli i Salford City³ ishte autoriteti i parë lokal i cili në vitin 2000 shprehu interesin për aplikimin e Buxhetimit me pjesëmarrje. Që nga ajo kohë e deri më tani, ka më shumë se 75 fusha në gjithë Anglinë, në të cilat është aplikuar procesi i Buxhetimit me pjesëmarrje. Është vlerësuar se popullsia lokale ka vendosur se si një sasi e parave prej 20 milion £ duhet të shpenzohet në shërbimet dhe projektet që variojnë nga punëtoritë e vallëzimit në rrugë në Stockton deri tek oficerët e policisë në lagje; nga një program anti-ngacmim në Southampton deri në një projekt kopshtarie në shkollë. Buxheti me pjesëmarrje nuk është i kufizuar në buxhetet e autoriteteve lokale. Projektet janë zbatuar me financim nga Trusti Primar i Përkujdesjes, Autoritetet e Policisë, departamente të qeverisë qendrore, marrëveshje të re për Komunitete, Partneritetet strategjike lokale, shoqatat e strehimit, këshillat e qytetit, famullitë dhe shkollat.

² Qytetërimi nuk njih moshë – Pjesëmarrja e fëmijëve në qeverisje dhe buxheti komunal i Barra Mansa

³ http://www.participatorybudgeting.org.uk/documents/PB_Toolkit_Sampler.pdf

4. Qyteti i Elbasanit në Shqipëri ka ndërmarrë veprime konkrete për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, përmes aplikimit të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje. Kryetari i Elbasanit i organizon 23 takime me komunitetin në lagjet e qytetit, në mënyrë që qytetarët, veçanërisht grupet me nevoja të veçanta, të jenë të përfshirë në procesin e planifikimit të buxhetit. Përmes këtij procesi Komuna synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në qeverisjen lokale, më konkretisht në procesin e hartimit të buxhetit.

Qyteti i Elbasanit e sheh buxhetimin me pjesëmarrje si një proces koordinimi të prioritetëve dhe vendimmarrje të përbashkët, përmes së cilit qytetarët dhe qeverisja vendore vendosin për alokimet financiare.


Zbatuesit e buxhetimit me pjesëmarrje kanë sugjeruar se procesi rezulton në shpenzime më të drejta publike, jetë të cilësisë më të lartë, kënaqësi më të madhe të nevojave bazë, transparencë dhe llogaridhënie të qeverisë, rritje të nivelit të pjesëmarrjes publike (sidomos nga banorët e marginalizuar ose të varfër), etj. Për më tepër, buxheti me pjesëmarrje në asnjë mënyrë nuk e zvogëlon rolin e këshilltarëve dhe të demokracisë përfaqësuese. Mandati dhe detyrat e këshilltarëve mbeten të njëjta në përputhje me mandatin që ata kanë në aprovimin përfundimtar të buxhetit komunal.

Mbështetja dhe përfshirja e këshilltarëve komunal në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje është kruciale, sepse këshilltarët i përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe në këtë mënyrë do të jenë në gjendje të japin përvojë në procesin e planifikimit, dhe t'i inkurajojnë zgjedhësit e tyre të përfshihen në proces. Ata gjithashtu mund të dinë për aktivitetet dhe grupet në bashkësi dhe t'i angazhojnë me pas ata në aktivitete në të mirë të komunitetit. Nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë, këshilltarët madje mund t'i udhëheqin vendimet e komunitetit dhe ta zvogëlojnë mundësinë e refuzimit të tyre nga Kuvendi.


Zbatuesit e Buxhetimit me Pjesëmarrje, sidomos këshilltarët, kanë parë përfitime direkte nga aplikimi i tij në praktikë. Qytetarë të fuqizuar, të cilët përfshihen në vendimmarrje, priren më shumë drejt votimit në zgjedhje. Gjithashtu, këshilltarët e përfshirë në buxhetimin me pjesëmarrje kanë parë rritje të besimit dhe legjitimitetit nga zgjedhësit e tyre.

SHEMBULLI I APLIKIMIT TË BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE NË ELBASAN


1. Ndarja e qytetit të Elbasanit në zona



1. Cikli i buxhetimit me pjesëmarrje sipas modelit të Elbasanit



Komiteti i buxhetimit me pjesëmarrje sipas modelit të Elbasanit



Qëllimi i buxhetimit me pjesëmarrje

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një proces relativisht i ri, i cili ofron mundësi dhe hapsirë të angazhimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e planifikimit komunal, duke i eliminuar dhe përmirësuar praktikën të cilat zbehin demokracinë përfaqësuese. Me përfshirjen e komuniteteve në identifikimin e prioriteteve dhe shpërndarjen proporcionale të buxhetit komunal, qeveritë lokale mund të reagojnë në mënyrë më efektive ndaj nevojave të komuniteteve të tyre. Procesi e rritë transparencën nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe mbajtjes së vendimmarrësve të përgjegjshëm ndaj publikut në përgjithësi, ndërton besimin dhe e përmirëson cilësinë e qeverisjes në qytet. Prandaj, mund të thuhet se objektivat e buxhetimit me pjesëmarrje janë:

- Sigurimi që financat e pushtetit lokal të llogariten siç duhet, duke e ulur potencialin për abuzim nga individët brenda dhe jashtë administratës lokale.
- Përfshirja e komuniteteve, me fokus të veçantë në grupet e marginalizuara dhe të lagjeve me të ardhura të ulta, në prioritizimin dhe procesin e buxhetimit.
- Rritja e pjesëmarrjes lokale të kulturës demokratike, promovimi i angazhimit civil dhe mbështetja e zhvillimit të kapitalit social.
- Sigurimi që fondet publike janë shpenzuar aty ku ka nevojë më së shumti dhe shmangia e përqendrimit të investimeve në zonat e banuara nga grupe të fuqishme dhe me ndikim të interesit.

Elementet kryesore të buxhetimit me pjesëmarrje

Informimi. Për të krijuar proces të suksesshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, duhet të kemi parasysh dy çështje themlore:

1. Një angazhim të vërtetë dhe të qëndrueshëm nga ana e organeve komunale në sigurimin e transparencës dhe ndryshmit të praktikave të kaluara të vendimmarrjes, si dhe
2. Të sigurohet informimi dhe ikurajimi i vazhdueshëm i qytetarëve në të gjitha fazat e procesit.

Pjesëmarrja. Suksesi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje është i bazuar në shkallën e pjesëmarrjes qytetare - qoftë pjesëmarrjes individuale apo përfaqësimit grupor. Një nga karakteristikat kryesore të buxhetimit me pjesëmarrje është njohja e drejtës së dikujt për të marrë pjesë individualisht dhe drejtpërdrejt dhe jo domosdoshmërisht nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive, sindikatave apo shoqatave të tjera. Për t'i shërbyer njërës nga parimet themelore të buxhetimit me

pjesëmarrje, është e domosdoshme të shqyrtohet se sa grupet e ndryshme të njerëzve janë të përfshirë në mënyrë efektive në këtë proces dhe në përfitimet e tij. Diversiteti i tillë duhet t'i marrë parasysh, për shembull çështjet e gjinisë, përkatësisë etnike dhe grupmoshave të ndryshme.

Miratimi përfundimtar i buxhetit dhe roli i Kuvendit të Komunës. Përvojat e shumicës së qyteteve të cilat kanë praktikuar buxhetimin me pjesëmarrje sugjerojnë se degat legjislative dhe ekzekutive duhet ta mbajnë rolin e tyre tradicional të miratimit të buxhetit. Ky element është shumë i rëndësishëm në atë që buxhetet pjesëmarrëse njohin si demokracinë përfaqësuese ashtu edhe pushtetin legjislativ. Mënyra më e përhapur dhe me efekte më të mëdha është ajo në të cilën buxheti është diskutuar dhe hartuar me pjesëmarrje të drejtepërdrejtë të qytetarëve në takimet publike dhe takime me grupe interesi.

Komunikimi i rezultateve. Një aspekt kyç i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje është planifikimi dhe publikimi i linjave buxhetore dhe sqarimeve shtesë, si: buxheti i propozuar dhe i aprovuar, projektet e planifikuara, shumat e aprovuara për projekte të veçanta investive dhe shpenzime tjera, afati kohor i fillimit dhe përfundimit të projekteve, etj.

Mënyrat më të zakonshme të informimit janë takimet publike në të cilat kryetari i komunës, Këshilli i Buxhetimit me pjesëmarrje dhe anëtarët e Kuvendit Komunal i japin llogari dhe i përgjigjen pyetjeve të qytetarëve. Këto janë zakonisht takimet vjetore në fillim të një cikli të ri të buxhetit me pjesëmarrje në çdo nën-rajon ose qark dhe gjatë forumeve tematike. Mjete të tjera për ndarjen e informacioneve në lidhje me llogaritë dhe buxhetin janë botimi i një gazete vjetore, broshurave ose raporteve të detajuara buxhetore.

Mekanizmat ligjor dhe rregullator për institucionalizimin e buxhetimit me pjesëmarrje. Është e rëndësishme që të përcaktohet se kur dhe si të formalizohet një proces i buxhetimit me pjesëmarrje për të siguruar jo vetëm suksesin e tij, por edhe efektivitetin dhe qëndrueshmërinë. Gjithashtu, është e rëndësishme për të vlerësuar nivelin e duhur të institucionalizimit në mënyrë që të ruhet dinamika e pjesëmarrjes. Nga përvoja, institucionalizimi apo formalizimi i buxhetit me pjesëmarrje mund të rregullohet më së miri përmes Rregullores së Brendshme ose edhe vendimeve tjera komunale, të cilat do të rregullonin: format e përfaqësimit, kriteret për shpërndarjen e burimeve, përgjegjësitë e këshillit të BP, numrin e takimeve plenare dhe fushat tematike, etj.

Hapat konkret drejt buxhetimit me pjesëmarrje të suksesshme

Hapi 1: Ndani territorin e administruar nga komuna në njësi gjeografike dhe demografike. Administrata komunale duhet të vendos për ndarjen e teritorit komunal në zona, në mënyrë që secilës zonë t'i krijoj mundësi pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Një ndarje e thjeshtë do të bazohet në lagje për zonat urbane dhe në bazë të fshatrave për zonat rurale. Por, përveç karakteristikave të komunës, ka një sërë faktorësh të tjerë që duhet të merren në konsideratë kur mirret vendimi për ndarjen e njësive. Mjaft shpesh, komunat merren me projekte që ndikojnë në fshatra të shumta dhe vendimi duhet të merret në bashkëpunim në mes të komuniteteve të prekura. Prandaj, zyrtarët komunal duhet të jenë fleksibil kur është fjala për ndarjen e territoreve të tyre në njësi.

Hapi 2: Informimi dhe motivimi i qytetarëve për pjesëmarrje në proces. Me qëllim të informimit dhe motivimit të qytetarëve për pjesëmarrje në gjithë procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, komunat duhet të ndërmarrin fushatë informimi publik, përmes publikimit të thirrjeve në web-faqen e komunës, organizimin e takimeve informative, shpërndarjen e broshurave sqaruese etj. Zyrtarët komunal gjithashtu duhet të sigurohen nëse qytetarët e kuptojnë saktë buxhetin e aprovuar, burimet financiare në dispozicion të cilat mund të investohen në lagjen ose fshatin e tyre, projektet të cilat do të realizohen dhe afatin kohor. Komunkimi i sinqertë me qytetarë do të krijonte proces transparent të planifikimit dhe do t'i eliminonte zhgënjimet e qytetarëve.

Hapi 3: Identifikimi i çështjeve dhe prioritetëve në komunitet. Në nivel të komunitetit, qytetarët i identifikojnë dhe priorizojnë çështjet me rëndësi më të madhe. Zgjedhja e prioritetëve bëhet përmes një procesi demokratik, qoftë përmes votimit të drejtpërdrejtë në mbledhjet e komunitetit ose përmes fletëve të votimit që qytetarët i plotësojnë dhe i hedhin në vende të caktuara. Nga perspektiva e administratave komunale, ky është hapi i dytë në këtë proces. Zyrtarët komunal duhet të punojnë me qytetarët dhe t'i trajtojnë ata në teknikat e identifikimit dhe priorizimit të çështjeve dhe problemeve të tyre.

Hapi 4: Renditja çështjeve dhe problemeve të komuniteteve. Ky është një proces që përfshin Këshillin e Buxhetimit me pjesëmarrje dhe bëhet përmes një takimi të përbashkët të të gjithë përfaqësuesve të Këshillit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Administrata komunale duhet të ketë rregulla dhe kritere të shkruara që e drejtojnë këtë pjesë të procesit. Ky është një nga hapat më të ndjeshëm, për shkak se komuna do të ketë gjithmonë burime të kufizuara në dispozicion dhe përfaqësuesit e ndryshëm të njësisë do të konkurrojnë për të njëjtën pjesë të parave.

Hapi 5: Monitorimi i projekteve. Për t'u siguruar që planifikimi i buxhetit realizohet sipas planit të aprovuar dhe dinamikës së paraparë, zyrtarët komunal ndërmarrin dhe organizojnë takime të vazhdueshme me qytetarë dhe grupe interesi. Mënyra më efikase për të përfshirë qytetarët në këtë proces vlerësimi ose monitorimi është vendosja në web-faqe të buxhetit të aprovuar dhe më pas informata në lidhje me procesin e zbatimit të projekteve konkrete, si:

- Projektet e Komunitetit të miratuara për financim janë postuar në njësi të komunës me buxhetin e alokuar dhe datat e përfundimit.
- Ndërkohë që zbatimi i projektit zhvillohet, azhurimet janë postuar në faqen e internetit të komunës, mjete të tjera elektronike ose në vetë komunitetet.

Hapi i parë që duhet të merret në qasjen ndaj procesit të pjesëmarrjes së qytetarëve në qeveritë lokale është rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve komunal dhe qytetarëve në përgjithësi për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në proces.

Çështja e pjesëmarrjes qytetare ka gjithashtu dy anë, të cilat duhet të merren në konsideratë për të siguruar një qasje ndryshe. Shpeshherë ka mungesë të vullnetit dhe përvojës nga ana e administratave komunale për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në njërin anë dhe gjithashtu ka edhe mungesë të njohurive në mesin e qytetarëve për të drejtën e tyre për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në drejtimin e jetës së tyre të përditshme në anën tjetër.

Parakushtet për proces efikas të buxhetimit me pjesëmarrje

1. **Zyrat komunale për informim.** Fokusi i përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve duhet të përqendrohet në Zyrat e Informacionit komunal, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për të komunikuar me publikun. Në përputhje me obligimet ligjore të dala nga Ligji për Qasje në dokumente publike, komunat janë të obliguara që të themelojnë një Njësit ose të caktojnë një zyrtar për komunikim me qytetarë, i cili merret me pranimin e kërkesave të qytetarëve dhe ofrimin e përgjigjeve.
2. **Themelimi i grupeve përfaqësuese në komunitet.** Një element për t'u konsideruar në themelimin e grupeve përfaqësuese të komunitetit, është specifika demografike e fshatit. Grupet duhet të përbëhen nga përfaqësues të lagjeve të ndryshme dhe ta shmangin perceptimin që anëtarët e grupit janë duke e përfaqësuar interesin e një subjekti të caktuar politik, e që ka qenë rasti në shumë vende. Kjo erdhi për shkak se përfaqësuesit e komunitetit u emëruan nga zyrtarët komunal, në vend se të zgjedhen nga vetë komunitetet. Nëse përzgjedhen ose zgjedhen përmes një procesi të hapur dhe transparent, grupet përfaqësuese të komunitetit mund të përfaqësojnë një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi midis komuniteteve dhe administratës lokale. Këto grupe madje mund të zgjedhen në atë mënyrë që të jenë homogjene dhe të përfaqësojnë kategori të ndryshme të komunitetit, si meshkuj, femra dhe të rinj. Kjo ndarje

do t'u mundësoj autoriteteve lokale për të vënë në shënjestër grupe të veçanta për çështje specifike, por gjithashtu për t'i përfshirë të gjithë ata kur bëhet fjalë për probleme të përgjithshme. Administratat komunale duhet të bëjnë llogaritje të duhura buxhetore, duke e përfshirë koston e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për stafin e zyrave të informimit, anëtarët e komitetit të komunitetit dhe grupeve përfaqësuese të komunitetit. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet grupeve përfaqësuese të komunitetit, pasi që duke qenë jashtë strukturave zyrtare qeverisëse, ata mund t'i përfaqësojnë më së miri interesat e komuniteteve të tyre duke marrë pjesë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes dhe duke ndikuar në vendimin e marrë nga zyrtarët lokal. Gjithashtu, do të ishte e dobishme në qoftë se përcaktohen qëllimet e qarta të punës për anëtarët e grupit përfaqësues të komunitetit, pasi që ata duhet ta kenë të qartë se cili është roli i tyre, çfarë pritet prej tyre dhe ata dhe komunitetet e tyre të përfitojnë nga përfshirja e tyre.

3. **Web faqja e komunave.** Një mjet i komunikimit që nuk është duke u shfrytëzuar siç duhet nga administratat lokale është faqja e internetit të komunave. Në epokën e sotme të teknologjisë së informacionit, ku *www* është përhapur në gjithë vendin, interneti mund të jetë një mjet i fortë për të komunikuar me publikun. Një analizë e zhvilluar me faqet e internetit të komunave tregoi se informatat që gjinden në faqet e internetit ndonjëherë janë një javë të vjetra, që do të thotë se publikut nuk i janë shërbyer informacione aktuale. Edhe më keq, mënyra se si informacioni është paraqitur në faqet e internetit, i bën ato të duken si mjete propagandistike për kryetarin e komunës dhe administratën komunale. Zyrtarët gjithashtu tregojnë vetëm "lajme të mira" në faqet e internetit, të cilat janë zgjedhur me kujdes për të rritur popullaritetin e zyrtarëve të zgjedhur. Kjo mënyrë e shërbimit të informacionit për publikun, i bën faqet tendencioze dhe ato e humbasin qëllimin e tyre informativ.

Zyra komunale e informacionit mund ta përdor faqen e internetit për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes duke e shfrytëzuar faqen e internetit në mënyrë të duhur. Për shembull, informacioni i servuar në internet mund të lidhet me rastet e suksesshme kur qytetarët kanë marrë pjesë në vendimmarrje ose kanë ndikuar në vendimet e strukturave komunale kryesore. Për më tepër, faqja e internetit mund të përmbaj shprehje e mirënjohje për individë të veçantë, të cilët mund të thuhet me emër, komunitete të veçanta dhe grupe të komunitetit që i përfaqësojnë. Mirënjohja mund të përmbaj një shënim falënderues të deklaruar nga kryetari i komunës, duke vlerësuar përfshirjen e qytetarëve për t'i ndihmuar administratat komunale në marrjen e vendimit të drejtë.

Faqja e internetit mund të përdoret gjithashtu për të organizuar veprimet e votimit, ku qytetarët mund të votojnë për një apo një tjetër projekt në lidhje me gjithë popullsinë e komunës. Faqja e internetit mund t'i zëvendësoj kutitë e

instaluara në objektet komunale të destinuara për ankesat e qytetarëve, të cilat nuk kanë funksionuar si duhet, sepse një numër shumë i vogël i qytetarëve bëri përpjekje për të shkruar letra dhe për t'i vendosur ato në kuti.

4. **Forumet Publike.** Nëpërmjet forumeve publike dhe duke i'u ofruar qytetarëve hapësira për të shkruar mesazhe të çfarëdo natyre në faqen e internetit, do të krijohet një dialog i drejtpërdrejtë mes zyrtarëve komunal dhe qytetarëve. Për më tepër, faqja e internetit gjithashtu mund të publikoj pyetësorë online për matjen e cilësisë së shërbimeve që administrata lokale ofron, ose të vlerësoj kënaqësinë e qytetarëve me administratën lokale në përgjithësi.
5. **Web Diskutimet.** Web diskutimet janë një mënyrë tjetër për shkëmbimin e informacionit midis përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe qytetarëve si dhe qytetarëve mes tyre. Interneti mund t'u ofroj zyrtarëve të zgjedhur përfitime të konsiderueshme, duke pasur parasysh faktin se ka një kosto shumë të ulët operative, është i hapur për një numër të gjerë të qytetarëve, lejon një sasi të pakufizuar të informacionit dhe është i shpejtë në ofrimin e informacionit për qytetarët. Duke pasur parasysh se një faqe e internetit është një mjet interaktiv dhe shumë dinamik i komunikimit, stafi komunal duhet të trajnohet për shfrytëzimin e internetit në arritjen e zgjedhësve të tyre.
6. **Takimet e drejtpërdrejta me qytetarë dhe grupe interesi.** Një tjetër mënyrë për të komunikuar drejtpërdrejt dhe për ta sjellur qeverinë më afër qytetarëve janë takimet ballë për ballë me komunitetet dhe grupet e interesit. E vërteta është se kjo mënyrë e komunikimit kërkon shumë kohë dhe përpjekje, por mund të jetë shumë efikase në përcjelljen e mesazheve të caktuara për zgjedhësit dhe i'u mundëson zyrtarëve të zgjedhur që drejtpërdrejt t'i dëgjojnë shqetësimet dhe problemet e qytetarëve. Takimet ballë për ballë mund të jenë një mjet i suksesshëm kur kanë të bëjnë me komunitetet më të vogla ose grupet e caktuara të interesit. Këto takime duhet të ndodhin në territorin e qytetarëve dhe jo vetëm të ftohen grupe të qytetarëve në ndërtesën e komunës. Këto vizita duhet të bëhen nga një zyrtar i rangut të lartë, mundësisht nga kryetari i komunës. Qytetarët duhet t'i shohim përpjekjet e zyrtarëve të zgjedhur për t'i takuar ata dhe të ndjehen të fuqizuar nga akti i vizitës. Organizimi i diskutimeve me fokus grupe i mundëson zyrtarët komunal për të diskutuar tema të veçanta me një grup njerëzish, të cilët janë zgjedhur në atë mënyrë që ta përfaqësojnë të gjithë popullsinë ose një grup të interesit. Nëpërmjet diskutimit, apo intervistimit të thjeshtë, qytetarët mund t'i japin pikëpamjet dhe reagimit e tyre në lidhje me një çështje të caktuar, e cila ka të bëjë me popullatën e përgjithshme ose një grup të veçantë të synuar. Diskutimet e fokus grupeve janë një ngjarje e hershme dhe puna e tyre është joformale, e që krijon një hapësirë për diskutim të hapur dhe të lirë të

pjesëmarrësve dhe jep një sërë përgjigjesh në lidhje me një problem. Fokus grupet zakonisht servojnë vetëm një temë të veçantë dhe shpërbëhen pasi të jetë zgjidhur çështja.

7. **Forumet qytetare.** Në shumicën e rasteve, roli i forumeve qytetare është të shqyrtoj çështje të caktuara dhe të japë rekomandime për autoritetet vendore në lidhje me zgjidhjet për problemet dhe temat. Në bazë të specifikave të komunës, forumet qytetare janë vendosur për të mbuluar çështje të veçanta, të tilla si forumet e konsumatorëve, të cilat merren me çështje të një shërbimi të caktuar, forume të bazuara në një temë dhe forume të grupimeve të caktuara të komunitetit, si minoritetet, të rinjtë, gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.
8. **Shkëmbimi i përvojave në mes komunave.** Një tjetër metodë që mund t'i ndihmoj komunat që të mësojnë nga njëra-tjetra është të siguroj që kryetarët e komunave dhe zyrtarët e informacionit të kenë takime të rregullta të paktën dy herë në vit dhe të shkëmbejnë informacione në lidhje me qasjet që i kanë përdorur ata me qytetarët, në mënyrë që që gjejnë mënyra për t'i shfrytëzuar ato edhe në komuna të tjera, me adoptimet në bazë të specifikave demografike dhe gjeografike të komunave.
9. **Kartat aktive të qytetarëve** mund të përdoren për ta inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve. Qytetarët, të cilët kanë marrë pjesë më shumë se pesë herë në takimet e thirrura nga autoritetet komunale, do t'u jepet karta që i shënojnë ata si qytetarë aktiv. Kuvendet komunale mund të vendosin mbi përfitimet që një bartës i kartës së qytetarit aktiv do t'i ketë. Qytetari aktiv për shembull mund të lirohet nga taksat kur të lëshohet një certifikatë, të mos presë në radhë gjatë marrjes së shërbimeve, apo përfitime të tjera që do t'i inkurajoj qytetarët më shumë për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes. Karta e qytetarit aktiv mund ti merret një personi në qoftë se ajo/ai ka dështuar të marrë pjesë në takimet me autoritetet komunale. Termat dhe kushtet duhet të vendosen nga secila komunë veç e veç.
10. **Angazhimi i qytetarëve në komisionet për shqyrtimin e ofertave/tenderit** mund të rrisë transparencën e administratave komunale dhe zvogëloj nivelin e korrupsionit në pushtetin lokal. Kjo qasje do të ndryshoj perceptimin e popullatës për nivelin e korrupsionit tek përfaqësuesit e tyre lokal. Për më tepër, ky angazhim do t'i fuqizoj qytetarët dhe t'i bëj ata pjesë të procesit të vendim-marrjes, kur është fjala për dhënien e granteve për kompanitë.

11. Drejtoritë Komunale hartojnë një plan të takimeve me grupe interesi. Në varësi të qëllimit të tyre të punës, Drejtoritë komunale duhet të hartojnë një plan të ngjeshur në terren që do t'i mundësoj atyre që të komunikojë drejtpërdrejt dhe të krijojnë një praktikë bashkëpunimi me zgjedhësit e tyre. Vizitat duhet të jenë konstruktive, të frytshme dhe të tregojnë rezultate të prekshme për popullsinë, në mënyrë që ata ta shohin një përfitim të drejtpërdrejtë nga pjesëmarrja në takimet me zyrtarët e tyre të pushtetit lokal. Këto vizita do të shërbejnë si një mjet për vlerësimin e nevojave të departamentit përkatës të klientëve. Rezultatet e këtyre takimeve do t'i ndihmojnë qeveritë vendore për ta përmirësuar nivelin e tyre të ofrimit të shërbimeve. Autoriteteve lokale duhet shpjeguar që një qytetar më shumë i kënaqur do të thotë një votë më shumë për mandatin e ardhshëm. Për të komunikuar me zgjedhësit e tyre të drejtpërdrejtë, zyrtarëve komunal do t'u duhen detajet e kontaktit të votuesve të tyre, sidomos të krerëve të familjeve në territorin e komunës së tyre.

Detajet e kontaktit mund të merren përmes policave rrugore, ku kalimtarëve u kërkohet informacioni i tyre ose të dhënat e kreut të familjes së tyre. Informacioni i marrë mund ta përfshij adresën postare, numrin e telefonit, telefonin celular dhe adresën e e-mailit. Sidomos telefoni celular dhe e-mail janë mjete të mira për të shpërndarë informacione për një numër të madh të njerëzve. Për më tepër, detajet e kontaktit mund t'i shtohen bazës së të dhënave të komunës dhe mund të ndahen sipas vendndodhjes (psh. lagje, fshat) ose sipas grupit të synuar (grupit të interesit) dhe në rastet kur çështja që do të diskutohet ka të bëjë vetëm me një pjesë të popullatës, vetëm ai grup i caktuar mund të ftohet në mbledhje.

Qytetarët mund të kërkohen që t'i japin adresat e tyre të rrjeteve të socializimit, të tilla si Facebook dhe Twitter dhe të krijojnë grupe të fansave me zgjedhësit e tyre. Ky mjet mund të përdoret veçanërisht për të komunikuar me qytetarët e brezit të ri dhe ofron mundësi të shumta nga votimi për të dhënë komente mbi projekte të ndryshme.

Rekomandimet për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje

Rekomandimet për komunat

Kushtet që duhet të plotësohen para se buxhetimi me pjesëmarrje të mund të shfrytëzohet si një mjet për pjesëmarrjen e qytetarëve:

- Duhet të ketë mbështetje të fuqishme të qeverisë për delegimin e autoritetit të drejtpërdrejtë për qytetarët.
- Komunat duhet të krijojnë parakushte për përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit, diskutimit të buxhetit komunal.
- Komunat duhet të jenë të gatshme për t'i zbatuar në përpikëri planet buxhetore të aprovuara dhe të rekomanduara nga qytetarët.
- Komunat përgatisin dhe shpërndajnë tek qytetarët draft buxhetin komunal dhe më pas buxhetin e aprovuar.
- Komunat duhet të jenë të gatshme për ta transformuar mënyrën e vendimmarrjes në nivel lokal.
- Proceset e brendshme administrative duhet të reformohen për të lejuar vendimmarrje të decentralizuar, si dhe për ta orientuar burokracinë për t'i zbatuar projektet e përzgjedhura nga pjesëmarrësit.
- Komunat duhet të rrisin buxhetin nga të hyrat dhe burimet tjera alternative në mënyrë që të përfshihen sa më shumë kërkesa dhe rekomandime të qytetarëve.

Rekomandimet për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OShC):

- Qytetarët duhet të dakordohen rreth kërkesave dhe prioritizimit të tyre në mënyrë që më pas të rekomandojnë projektete sipas prioriteteve të diskutuara.
- Qytetarët duhet të ushtrojnë presion të vazhdueshëm në komunë, për tu marrë parasysh dhe trajtuar kërkesat dhe rekomandimet e tyre.
- Qytetarët duhet të ushtrojnë presion tek anëtarët e Kuvendit komunal ose edhe subjektet politike.
- OSHC-të dhe qytetarët duhet të jenë të gatshëm të punojnë afër me zyrtarët e qeverisë. Bashkëpunimi është vendimtar për t'u lejuar palëve të shumta për të punuar drejt zgjidhjeve të mundshme politike. Bashkëpunimi i inkurajon zyrtarët qeveritarë që të vazhdojnë ta delegojë autoritetin.
- Bashkëpunimi i inkurajon qytetarët që të kërkojnë aleanca komunë - qytetarë për të prodhuar reforma politike.
- OSHC-të dhe qytetarët duhet të jenë të gatshëm për të përdorur format publik të BP për t'u bërë presion zyrtarëve të qeverisë dhe që publikisht t'i denoncojnë keqbërjet/ose mosveprimet.

Misioni i ATRC-së

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse kosovare që punon për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale. ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin kampanja të avokimit; dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes avokimit, ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit në Kosovë e jashtë saj.

Ky publikim është përgaditur nga ATRC, dhe përkrahur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.
Qëndrimet e shprehura në këtë udhëzues jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.





Advocacy Training & Resource Center - ATRC
Rr. Gazmend Zajmi, Nr.20
10 000 Prishtina, Kosova
Tel: + 381 38 244 810
E-mail: info@advocacy-center.org
Web: www.advocacy-center.org

“Bringing out the advocate in everyone”